




NJOFTIM

Dëgjim publik për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027

15.02.2023
Vendi: Salla e Kuvendit
Komunal në Gjiçan
Ora: 10:00

Të dashur bashkëqytetarë të Gjiçanit,

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027 që do të ju prezantojmë në këtë takim publik është i një rëndësie të veçantë për komunitetin e Gjiçanit, i cili është dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal. Qëllimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjiçanit, 2023-2027, është që të identifikoj dhe ofroj zgjidhje për problemet prioritare për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Gjiçanit, duke synuar në një menaxhim efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe duke marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme opinionin e publikut.

Kërkesat, komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në e-mail adresën: mentor.mihovci@rks-gov.net.

Mirë se vini!